

Për: **POLICINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Adresa: 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nga: **ZNJ. MAJLINDA BREGASI**

Nr. Personal:

Adresa: Rruga Lidhja e Prizrenit nr. 21, 10000 Prishtinë

Në bazë të nenit 79 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (Kodi Nr.04/L-123), znj. Majlinda Bregasi (tani e tutje “E dëmtuara”) nëpërmjet të autorizuarit të saj, e paraqet këtë,

KALLËZIM PENAL

Ndaj të dyshuarit:

Zt. Gani Jakupi, shtetas i Republikës së Kosovës, me adresë të banimit në Prishtinë, rruga Antigona Fazliu, nr.5, me numër personal..... Numri i telefonit: (tani e tutje “I dyshuari”).

Për shkak të veprave penale:

- Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 të KPRK-së;
- Shpërlarja e parave, nga neni 302 të KPRK-së
- Shmangia nga tatimi, nga neni 307 i KPRK-së;
- Mashtrimi, nga neni 323 i KPRK-së;
- Konflikti i interesit, nga neni 417 i KPRK-së;
- Falsifikimi i dokumentit zyrtar, nga neni 427 i KPRK-së; dhe
- Veprat e tjera penale që mund të zbulohen gjatë procedurës penale.

Për shkak se:

Ekziston dyshim i bazuar se, z. Gani Jakupi, në cilësinë e bashkëthemeluesit të OJQ-së, Institutit Për ART-ProARTE Institute (PART), me numër të regjistrimit 5400119-3, me seli në Prishtinë, rruga Antigona Fazliu, nr.5 (Tani e tutje “ Institutit ose OJQ”, i ka keqpërdorur dhe i ka tejkalluar autorizimet, duke i shfrytëzuar në mënyrë të kundërligjshme mundësitë

lidhur me pozitën e tij zyrtare apo autorizimet si bashkëthemelues i Institutit. I dyshuari ka përdorur kundërligjshëm autorizimet e tij si person zyrtar në kundërshtim me interesat dhe qëllimet për të cilin janë dhënë këto autorizime. Me këto veprime i dyshuari i ka shkaktuar dëme të mëdha materiale të dëmtuares, OJQ-së dhe buxhetit të Republikës së Kosovës.

Ekziston dyshim i bazuar se, z. Gani Jakupi, në cilësinë e bashkëthemeluesit të OJQ-së, i ka falsifikuar dokumentet e OJQ-së dhe të njëjtat i ka dorëzuar në institucionet publike me rastin e aplikimit për projekte të caktuara dhe po ashtu, dokumentet e falsifikuara i ka përdorur me rastin e nënshkrimit të kontratave me institucionet publike, ku nga këto kontrata i dyshuari ka përfituar dhjetëra mijëra euro.

Egziston dyshim i bazuar se, z. Gani Jakupi, në cilësinë e bashkëthemeluesit të OJQ-së, e ka përdorur dhe e ka shfrytëzuar llogarinë bankare të OJQ-së për të pranuar pagesa personale nga personat e tretë.

Ekziston dyshim i bazuar se, z. Gani Jakupi, derisa ka qenë i angazhuar si këshilltar i jashtëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS), e ka përdorur OJQ-në për të nënshkruar kontratë me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe ka pranuar pagesa nga MKRS-ja në shumën prej dhjetëra mijëra euro.

Egziston dyshimi i bazuar se, z. Gani Jakupi, në kundërshtim me dispozitat statutare të OJQ-së dhe me dispozitat ligjore, e ka organizuar dhe mbajtur kuvendin/mbledhjen e OJQ-së, si dhe ka nxjerrë vendime të kundërligjshme për dhe në emër të OJQ-së.

Në veprimet e lartëcekura, konsiderojmë se janë konsumuar elementet e veprave penale, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, shpëlarja e parave, shmangia nga tatimi, mashtrimi, konflikti i interesit dhe falsifikimi i dokumentit zyrtar.

Arsyetimi i kallëzimit penal:

1. Policia e Republikës së Kosovës në Prishtinë, në rastin konkret ka kompetencë në pikëpamje lëndore dhe territoriale për ta trajtuar këtë kallëzim penal. Kompetenca lëndore rrjedh nga fakti se ekziston dyshimi i bazuar se i dyshuari i ka kryer veprat penale, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, shpëlarja e parave, shmangia nga tatimi, mashtrimi, konflikti i interesit dhe falsifikimi i dokumentit zyrtar. Ndërkaq, kompetenca territoriale rrjedh nga fakti se veprat penale dyshohet se janë kryer në territorin e Komunës së Prishtinës.

2. Me datën 1 shkurt 2021, e dëmtuara Majlinda Bregasi dhe i dyshuari Gani Jakupi e kanë miratuar aktin themeltar të organizatës jo-qeveritare, Institutit Për ART-ProARTE Institute (PART), me numër të regjistrimit 5400119-3, me seli në Prishtinë, rruga Antigona Fazliu, nr.5.

3. Në të njejtën datë (1 shkurt 2021), e dëmtuara Majlinda Bregasi dhe i dyshuari Gani Jakupi e kanë miratuar edhe statutin e organizatës jo-qeveritare, Institutit Për ART-ProARTE Institute (PART).

Prova # 1: Kopja aktit themeltar të OJQ-së, i datës 01.02.2021.

Prova # 2: Kopja e statutit të OJQ-së, i datës 01.02.2021.

4. Sipas letërkonfirmimit Ref. 2620/2021 të lëshuar nga Departamenti për OJQ pranë Ministrisë së Administratës Publike me datë 31.05.2021, vërtetohet se Instituti Për ART-ProARTE Institute (PART) është regjistruar me numër të regjistrimit 5400119-3 dhe me adresë në Prishtinë, Mati 1, banesat e Standardit, blloku II, hyrja 4 n.

Prova # 3: Kopja e letërkonfirmimit Ref. 2620/2021, e datës 31.05.2021.

5. Në muajin qershor të vitit 2021, është hapur llogaria bankare e OJQ-së në Bankën Kombëtare Tregtare në Prishtinë, me numër.....

Prova # 4: Kopja e letërkonfirmimit nga Banka Kombëtare Tregtare, e datës 17.06.2021.

6. Në muajin prill të vitit 2024, e dëmtuara është informuar nga zyrtarët e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Republikës së Kosovës (MKRS) se, Instituti Për ART-ProARTE Institute (PART) ka aplikuar në MKRS në një projekt kulturor për art dhe kulturë, si dhe e ka nënshkruar edhe një kontratë me MKRS-së, ku vlera e kësaj kontrate është në shumën prej dhjetëra mijëra euro.

E dëmtuara nuk ishte në dijeni për një projekt të tillë, prandaj, ajo menjëherë kishte parashtruar kërkesë në MKRS-së për marrjen e kopjes së projektit i cili në emër të Institutit ishte dorëzuar në MKRS.

Brenda afatit ligjor, MKRS-ja kishte kthyer përgjigje pozitive në kërkesën e të dëmtuarës, duke ia dhënë të dëmtuares një kopje të projektit i cili ishte dorëzuar në MKRS. **Ky projekt është miratuar nga ana e MKRS-së dhe siç duket Instituti i ka pranuar të gjitha parat e projektit nga MKRS-ja.**

Nga përmbajtja e dokumentacionit të projektit të cilin e dëmtuara e kishte pranuar nga MKRS-ja, rezulton se:

- a. Si bartës të projekteve në emër të Institutit ishin paraqitur persona të ndryshëm, të cilët asnjëherë nuk kanë qenë të punësuar apo të angazhuar nga Instituti.
- b. Si kontraktor, si bashkëpunëtor të jashtëm dhe si ekspert të Institutit, ishin paraqitur persona dhe kompani të cilët asnjëherë nuk kanë qenë të punësuar dhe të angazhuar nga Instituti.
- c. Edhe pse Instituti asnjëherë nuk kishte themeluar Bord të Drejtorëve, në dokumentacionin e pranuar nga MKRS-ja, rezulton se në cilësinë e drejtorëve në Bordin e Drejtorëve ishin shënuar personat Nita Deda, Ag Apolloni dhe Qëndrim Gashi.
- d. Si total i të ardhurave të Institutit në vitin 2022, ishte paraqitur shuma prej 30,500.00 Euro. E dëmtuara, nuk është në dijeni nga cili aktivitet konkret i Institutit janë të realizuara këto të ardhura.

Në rastin konkret ose kemi të bëjmë me të dhëna dhe me dokumente të falsifikura të cilat i dyshuari në emër të Institutit i kishte dorëzuar në MKRS ose kemi të bëjmë me vendime të paligjshme të cilat i dyshuari i kishte nxjerrë në emër të Institutit, me të cilat është themeluar Bordi i Drejtorëve të Institutit, janë punsuar edhe angazhuar personat e përmendur në dokumentacionin e pranuar nga MKRS-ja.

Prova # 5: Kopja e dokumentacionit të pranuar nga MKRS-ja.

7. Sipas dispozitave statutare të Institutit, i dyshuari, në asnjë rrethanë nuk kishte të drejtë që “krye n’veti” ta themelonte Bordin e Drejtorëve të OJQ-së, ngase në dispozitën e nenit 4 par.1 të statutit të OJQ-së e cila fletë për Bordin e Drejtorëve të OJQ-së është përcaktuar: ***përbërja e parë e Bordit të Drejtorëve emërohet nga themeluesit.***

Nga përmbajtja e kësaj dispozite statutare shihet qartë se për themelimin e Bordit të Drejtorëve duhet aprovimi edhe i themelueses tjetër, në këtë rast të dëmtuares Majlinda Bregasi.

E dëmtuara si bashkëthemeluese asnjëherë nuk kishte marrë pjesë në ndonjë mbledhje të rregullt apo të jashtëzakonshme për themelimin e Bordit të Drejtorëve dhe po ashtu, e dëmtuara nuk e kishte dhënë asnjëherë aprovimin e saj për themelimin e Bordit të Drejtorëve të Institutit.

8. Pas pranimit të dokumentacionit nga MKRS-ja në lidhje me projektin e listuar në provën numër 5, e dëmtuara me datën 9 prill 2024 kishte kërkuar skjarime nga i dyshuari lidhur me projektin e dorëzuar në MKRS dhe për të hyrat financiare të Institutit.

Me datën 9 prill 2024, i dyshuari i kishte kthyer përgjigje të dëmtuares, me të cilën e njofton të dëmtuaren se të hyrat financiare të Institutit do ti precizoj pasi të kthehet nga Madridi. Edhe pse kanë kaluar më shumë se pesë muaj, i dyshuari nuk ia kishte dërguar të dëmtuarës të hyrat financiare të Institutit dhe poashtu, i dyshuari nuk ia kishte dërguar të dëmtuarës as dokumentet e kërkuara në lidhje me projektin e dorëzuar në MKRS.

Prova # 6: Përgjigja e të dyshuarit e datës 9 prill 2024.

9. Me datën 29 maj 2024, e dëmtuara iu kishte drejtuar me kërkesë të veçantë të dyshuarit dhe të tjerëve, me të cilën kishte kërkuar që t'ia dërgojnë të gjitha vendimet të cilat janë marrë në emër të OJQ-së, gjendjen e llogarisë bankare të OJQ-së, pasqyrat financiare etj.

Në të njejtën datë (29.05.2024), e dëmtuara e kishte dërguar edhe një kërkesë tjetër në adresë të dyshuarit dhe të tjerëve, me të cilën kishte kërkuar sqarime nëse i dyshuari ka dorëzuar dokumente të Institutit në Departamentin për OJQ me seli në Prishtinë.

Prova # 7: Kopjet e kërkesave të të dëmtuares të datës 29 maj 2024.

10. Me datën 2 qershor 2024, e dëmtuara e kishte pranuar një përgjigje nga znj. Ensara Haliti, me të cilën znj. Haliti me rol 'drejtoreshë ekzekutive e Institutit, e kishte njoftuar të dëmtuarën se gjendet në vizitë zyrtare jashtë vendit dhe për rrjedhojë e ka të

pamundur qasjen në dokumentacionin e kërkuar. Por, kanë kaluar më shumë se tre (3) muaj dhe e dëmtuara ende nuk e ka pranuar dokumentacionin, të cilin e ka kërkuar me kërkesat e datës 29 maj 2024.

Prova # 8: Kopja e përgjigjes e datës 2 korrik 2024.

11. Me datën 3 qershor 2024, e dëmtuara ia kishe dërguar edhe një kërkesë tjetër të dyshuarit dhe të tjerëve, me të cilën e kishte ripërsëritur kërkesën e saj për dokumentacionin të cilën e kishte kërkuar me kërkesat e datës 29 maj 2024, siç janë vendimet të cilat janë marrë në emër të OJQ-së, gjendjen e llogarisë bankare të OJQ-së, pasqyrat financiare etj.

Prova # 9: Kopja e kërkesës e datës 3 qershor 2024.

12. Me datën 10 qershor 2024, e dëmtuara e kishte pranuar një përgjigje nga znj. Ensara Haliti, me të cilën znj. Haliti kërkon dialog dhe konstruktivitet, por përsëri nuk ia dërgon të dëmtuares dokumentacionin, të cilin e kishte kërkuar me kërkesat e datës 29 maj 2024 dhe 3 qershor 2024.

Prova # 10: Kopja e përgjigjes e datës 10 qershor 2024.

13. Me datën 28 Gusht 2024, në ora 15:46, e dëmtuara e kishte pranuar nje ftesë nga Instituti për të marrë pjesë në mbledhje të Bordit të Drejtorëve të Institutit, ndërsa mbledhja ishte caktuar për datën 30.08.2024, në ora 10:00.

Me datën 30 gusht 2024, në ora 9:18, e dëmtuara nëpërmjet të autorizuarit të saj kishte kërkuara nga i dyshuari dhe të tjerët që të shtyhet mbajtja e mbledhjes së jashtëligjshme e caktuar me datë 30.08.2024, për arsyet si në vijim:

- a. Ftesa për pjesëmarrje në mbledhjen e datës 30.08.2024 është dërguar në adresë të të dëmtuares me datë 28.08.2024, në ora 15:46.
- b. Caktimi i mbledhjes së datës 30.08.2024 është bërë në shpërputhje të plotë me dispozitat statutare dhe me dispozitat ligjore, sepse:
 - i. Themeluesit nuk kanë emëruar Bord të Drejtorëve dhe për rrjedhim, nuk mund të mbaj mbledhje një organ i cili ende nuk është themeluar.

- ii. Nuk është e lejuar me dispozitat statutare që mbledhja të caktohet 18 orë më herët apo themeluesi të njoftohet për mbledhje 18 orë para mbajtjes së mbledhjes.
- iii. Nuk ka rend dite.
- iv. Nuk janë dërguar materialet që do të shqyrtohen në këtë mbledhje.

E dëmtuara nuk ka pranuar asnjë përgjigje nga i dyshuari në lidhje me kërkesën e parashtruar për shtyrjen e mbledhjes së datës 30.08.2024 dhe siç duket, i dyshuari në cilësinë e bashkëthemeluesit e ka mbajtur mbledhjen e datës 30 gusht 2024 dhe ka marrë vendime të kundërligjshme në emër të Institutit.

Prova # 11: Kopja e ftesës për mbledhjen e jashtëligjshme të Bordit të Drejtorëve, e datës 28 gusht 2024.

Prova # 12: Kopja e kërkesës të autorizuarit të dëmtuares për shtyrjen e mbledhjes së jashtëligjshme.

14. Në përgjigjen e datës 9 prill 2024, të cilën i dyshuari ia kishte dërguar të dëmtuares, ka deklaruar shpërndishtë: *hymjet financiare t'sakta t'i precizoj kur t'kthehem në Bruksel, sepse kam marrë diçka personalisht nga Goethe Institut dhe e kam kalue në ProARTE, por m'duhet m'e vërtetue shumën n'arkivë (ka qenë para se Ensara m'e marre detyrën, ajo nuk i ka këto dokumente).*

Siç duket i dyshuari ka pranuar pagesa personale nga personat e tretë, të cilat nuk kanë asnjë lidhje me aktivitetin dhe veprimtarinë e Institutit, si dhe e ka përdorur llogarinë bankare të Institutit për t'i pranuar këto pagesa. Në fakt, shqetësimi i dëmtuares ka të bëjë me faktin se:

- a. Cili ishte motivi i të dyshuarit që e ka përdorur llogarinë bankare të Institutit për pranimin e pagesave personale, për shpëlarje të parave apo për shmangie të tatimit?
- b. Sa herë i dyshuari e ka përdorur llogaria bankare e institutit për pranimin e pagesave personale?
- c. Sa është shuma e pagesave personale të cilat i dyshuari i ka pranuar duke e përdorur llogarinë bankare të Institutit?
- d. Kush janë personat e tretë të cilët kanë bërë pagesa personale për të dyshuarin duke e përdorur llogarinë bankare të Institutit?

Duke qenë se i dyshuari refuzon që t'ia dërgojë të dëmtuares pasqyrat financiare të Institutit dhe gjendjen e llogarisë bankare të Institutit, e dëmtuara është e detyruar që rastin për hetim ta referoj në Policinë e Republikës së Kosovës.

Prova # 13: Shih provën nr.6.

15. Në përgjigjen e datës 9 prill 2024, i dyshuari prezantohet si këshilltar i jashtëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Republikës së Kosovës (MKRS), ndërsa Instituti në të cilën i dyshuari është bashkëthemelues ka aplikuar për projekte në MKRS, ka nënshkrar kontrata me MKRS-në, si dhe ka pranuar mjete financiare në shuma të konsiderueshme nga MKRS-ja.

Prova # 14: Shih provën nr.6.

16. Rrjedhimisht, bazuar në këto prova që u përmenden si më sipër, të cilat ia kemi bashkangjitur këtij kallëzimi penal, i propozojmë Policisë së Republikës së Kosovës që ta pranojë kallëzimin penal, të ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale në koordinim me Prokurorinë e Shtetit dhe pas vërtetimit të fakteve, të ngrihet aktakuzë me propozim që i dyshuari të dënohet sipas ligjit. Jemi në dispozicion të Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë së Shtetit që në çdo fazë të procedurës penale të ndihmojmë procesin me sqarimet e nevojshme.

17. Si kallëzues për dyshimin në lidhje me kryerjen e veprave penale të lartpërmendura të përcaktuara me dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, kemi të drejtë që në të gjitha fazat e procedurës penale në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës, të paraqesim prova shtesë dhe propozime për prova materiale dhe personale sipas nevojës, në lidhje me veprimet inkriminuese të të dyshuarit, veprime të cilat i kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme financiare të dëmtuares Majlinda Bregasi, Institutit Institutit Për ART-ProARTE Institute (PART), si dhe buxhetit të Republikës së Kosovës.

Të bashkangjitura i gjeni:

1. Kopja aktit themeltar të OJQ-së, i datës 01.02.2021.
2. Kopja e statutit të OJQ-së, i datës 01.02.2021.
3. Kopja e letërkonfirmimit Ref. 2620/2021, e datës 31.05.2021.
4. Kopja e letërkonfirmimit nga Banka Kombëtare Tregtare, e datës 17.06.2021.
5. Kopja e dokumentacionit të pranuar nga MKRS-ja.
6. Përgjigja e të dyshuarit e datës 9 prill 2024.

7. Kopjet e kërkesave të të dëmtuares të datës 29 maj 2024.
8. Kopja e përgjigjes e datës 2 korrik 2024.
9. Kopja e kërkesës e datës 3 qershor 2024.
10. Kopja e përgjigjes e datës 10 qershor 2024.
11. Kopja e ftesës për mbledhjen e jashtëligjshme të Bordit të Drejtorëve, e datës 28 gusht 2024.
12. Kopja e kërkesës të autorizuarit të dëmtuares për shtyrjen e mbledhjes së jashtëligjshme.
13. Autorizimi për përfaqësimin e të dëmtuares.

E dëmtuara, Majlinda Bregasi nga Prishtina
Sipas autorizimit, Av. Besim Osmani, me
adresë të zyrës në Prishtinë, rruga Zenel
Salihu, nr.120, Kati III/8

/ nënshkrimi & vula /

Në Prishtinë,
Data, 16 shtator 2024.